

Akuzat e Rosisë - paraqitja e dëshmime të vërteta

Agresioni i Rosisë ndaj Ukrainës ka çuar në izolimin ndërkombëtar të Rosisë, duke përfshirë pezullimin e të gjithë bashkëpunimit praktik të NATO-s me Rusinë.

Për të shmangur vëmendjen nga veprimet e saj, Rusia ka ngritur një varg akuzash kundër NATO-s, të cilat bazohen në shtrembërime të fakteve dhe shpërfillin përpjekjet e pareshtura të ndërmarra nga NATO për ndërtimin e një partneriteti me Rusinë.

Rusia ka bërë gjithashtu sulme të pabazuara mbi legjitimitetin e autoriteteve ukrainase dhe ka përdorur forcën për të pushtuar pjesë të territorit të Ukrainës.

Ky dokument paraqet gjendjen e vërtetë.

Marrëdhëniet NATO-Rusi

Rusia mëton se NATO ka shpenzuar vite duke u përpjekur për ta mënjanuar atë ndërkombëtarisht.

Që prej fillimviteve 1990, Aleanca ka punuar vijimisht për të ndërtuar një marrëdhënie bashkëpunuese me Rusinë në fusha me interes të ndërsjellë me synimin drejt një partneriteti strategjik.

Para rënies së Bashkimit Sovjetik dhe të Traktatit të Varshavës, NATO filloi të zgjaste dorën, duke ofruar dialog në vend të ballafaqimit, siç e bëri të qartë Takimi i Londrës i NATO-s në korrik 1990 (deklarata [këtu](#)). Në vitet në vijim, Aleanca i dha shtysë dialogut dhe bashkëpunimit nëpërmjet krijimit të forumeve të reja, Partneriteti për Paqe (PpP) dhe Këshilli i Partneritetit Euro-Atlantik (KPEA), të hapura për të gjithë Evropën, përfshirë Rusinë (dokumentet themelore [këtu](#) dhe [këtu](#)).

Si shenjë e rolit të veçantë të Rosisë në sigurinë Euro-Atlantike, më 1997, NATO dhe Rusia nënshkruan Aktin Themelues mbi Marrëdhëniet e Ndërsjella, Bashkëpunimin dhe Sigurinë, duke krijuar Këshillin e Përbashkët të Përhershëm NATO-Rusi. Më 2002 ata e përforcuan më tej këtë marrëdhënie, duke krijuar Këshillin NATO-Rusi (KNR). (Akti Themelues mund të lexohet [këtu](#), Deklarata e Romës e cila krijoi KNR-në [këtu](#)).

Që nga themelimi i KNR-së, NATO dhe Rusia kanë punuar bashkërisht për çështje që luhaten nga lufta kundër lëndëve narkotike dhe kundër terrorizmit deri në shpëtimin e nëndetëseve dhe planëzimin e çështjeve civile në situata të jashtëzakonshme. Asnjë partneri tjetër nuk i është ofruar një marrëdhënie e krahasueshme.

Larg prej mënjanimit të Rosisë, NATO e ka trajtuar atë si një partner të privilegjuar.

Vijimësia dhe zgjerimi i NATO-s

Zyrtarët rusë thonë se NATO duhej të ishte shpërndarë në fund të Luftës së Ftohtë dhe se pranimi i aleatëve të rinj nga Evropa Qendrore dhe Lindore minon sigurinë e Rosisë.

NATO nuk u shpërnda pas Luftës së Ftohtë, sepse anëtarët e saj donin ta ruanin lidhjen që kishte garantuar sigurinë dhe stabilitetin në zonën transatlantike, siç e qartëson Deklarata e Londrës: “Ne kemi nevojë për të vijuar të qëndrojmë së bashku, për të zgjidhur paqen afatgjatë që kemi gëzuar këto katër dhjetëvjeçarët e fundit”. Duke u mbështetur në vlerat që e kanë udhëhequr gjithmonë atë, NATO u bë më shumë se një aleancë e fuqishme ushtarake: ajo u shndërrua në një forum politik për dialog dhe bashkëpunim.

Politika e Dyerve të Hapura të NATO-s ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e bazuar në zgjedhjen e lirë të demokracive evropiane. Kur Ukraina vendosi të ndjekë një “politikë jashtë blloqeve”, NATO respektoi plotësisht atë zgjedhje. Pohimi kohëzgjatë i Rosisë se NATO u përpoq ta detyronte Ukrainën të përfshihej në radhët e saj, ishte dhe mbetet krejtësisht i pavërtetë.



NATO i ka përmbushur kushtet e Nenit 10 të Traktatit të Atlantikut të Veriut (që gjendet [këtu](#)), në të cilin theksohet se aleatët “munden, me marrëveshje të njëzëshme, të ftojnë çdo shtet tjetër evropian, që është në gjendje të çojë përpara parimet e këtij Traktati dhe të japë ndihmesë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut, për të hyrë në këtë Traktat”.

Në gjashtë raste, ndërmjet viteve 1952 dhe 2009, vendet evropiane bënë zgjedhjen për të kërkuar anëtarësim në bazë të një procesi demokratik dhe të respektimit të rendit ligjor. Aleatët e NATO-s bënë zgjedhje të njëzëshme për t'i pranuar ato.

Zgjerimi i NATO-s dhe i BE-së ka ndihmuar shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore për t'u dhënë rrugëzgjidhje reformave të vështira, të cilat ishin të nevojshme përpara pranimit. Ajo ka ndihmuar qytetarët e tyre të gëzojnë përfitimet e zgjedhjes demokratike, të rendit ligjor dhe të rritjes së ndjeshme ekonomike. Këto përpjekje e kanë çuar Evropën më afër drejt të qenit një e tërë, e lirë dhe në paqe nga çdo kohë tjetër në histori.

Rusia gjithashtu u pajtua me këtë këndvështrim në Aktin Themelues. Ajo u zotua për “krijimin në Evropë të një hapësire të përbashkët të sigurisë dhe stabilitetit, pa vija ndarëse apo sfera ndikimi” dhe për “respektimin e sovranitetit, të pavarësisë dhe të tërësisë territoriale të të gjitha shteteve dhe të drejtës së tyre të qenësishme për të zgjedhur mjetet për ruajtjen e sigurisë së tyre”.

Në kundërshtim me këto zotime, Rusia tani duket se po përpiqet për të rikrijuar një sferë ndikimi me anë të pushtimit të një pjese të Ukrainës, duke mbajtur një numër të madh forcash në kufijtë e saj dhe duke kërkuar, ashtu si ministri i jashtëm rus Sergei Lavrov ka theksuar kohët e fundit se “Ukraina nuk mund të jetë pjesë e ndonjë blloku”.



Mëtimet ruse se NATO premtoi që nuk do të zgjerohet

Zyrtarët rusë mëtojnë se zyrtarët amerikanë dhe gjermanë premtuan më 1990 që NATO nuk do të zgjerohet në Evropën Lindore dhe Qendrore, nuk do të ndërtonte infrastrukturë ushtarake pranë kufijve të Rusisë ose të vendoste trupa të përhershme atje.

Asnjë premtim i tillë nuk është bërë dhe nuk ka prova për të mbështetur mëtimet e Rusisë. Nëse një premtim i tillë do të ishte bërë nga NATO, ai do të duhej të kishte qenë si një vendim zyrtar, me shkrim nga të gjithë aleatët e NATO-s. Për më tepër, vlerësimi i zgjerimit të NATO-s filloi vite pas ribashkimit të Gjermanisë. Kjo çështje nuk ishte ende në rendin e ditës kur Rusia mëton se ishin bërë këto premtime.

Thëniet e pavërtetuara rreth zotimit të NATO-s për të mos ndërtuar infrastrukturë afër Rusisë janë po ashtu të pasakta. Në Aktin Themelues, NATO përsëriti “në mjedisin e sigurisë së tanishme dhe të një të ardhmeje të afërt, Aleanca do të kryejë misionet e saj të mbrojtjes së përbashkët dhe të tjera nëpërmjet sigurimit të aftësive, integritetit dhe ndërveprimit të nevojshëm me anë të përforcimit sesa me vendvendosje të përhershme plotësuese të forcave të ndjeshme luftarake. Përkritazi me këtë, ajo do të duhet të mbështetet në infrastrukturë të mjaftueshme në përpjesëtim të drejtë me detyrat e mësipërme. Në këtë kontekst, përforcimi mund të ndodhë, kur të lindë e nevojshme, në rast të një mbrojtjeje kundër kërcënimit për agresion dhe të misioneve në mbështetje të paqes në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet udhëheqëse të OSBE-së, si dhe për stërvitje në përputhje me Traktatin e përshtatur të Forcave Konvencionale (TFK) në Evropë, dispozitat e Dokumentit të Vjenës 1994 dhe masat transparente të pranuar ndërsjellas”.

NATO ka mbështetur me të vërtetë përmirësimin e infrastrukturës ushtarake, të tillë si bazat ajrore, në vendet të cilat kanë hyrë në Aleancë, në përputhje me kërkesat për përforcim dhe stërvitje. Megjithatë, të vetmet forca luftarake të vendosura mbi baza të përhershme në territorin e anëtarëve të rinj janë forcat e tyre të armatosura.

Edhe para krizës së Ukrainës, e vetmja shenjë e dukshme e praktikës së përditshme të forcave të Aleancës ndër anëtarët e rinj ishin aeroplanët e NATO-s të përdorur në shtetet baltike për misionin e ruajtjes me patrullim ajror. Këto mjete të pakta mbrojtëse nuk mund të përshkruhen si forca luftarake të ndjeshme në frymën e Aktit Themelues.

Që prej krizës, NATO ka ndërmarrë hapa për të rritur njohjen e situatës dhe për të forcuar mbrojtjet e anëtarëve tanë lindorë. Kjo, gjithashtu, është plotësisht në përputhje me Aktin Themelues dhe është një pasojë e drejtpërdrejtë e veprimeve ushtarake destabilizuese të Rusisë.

Së fundi, në Akt gjithashtu theksohet: “Rusia do të ushtrojë kufizim të ngjashëm në përqendrimet e forcave të saj konvencionale në Evropë”. Agresioni i Rusisë kundër Ukrainës është një shkelje e hapur e këtij zotimi, ashtu sikurse është pezullimi i njëanshëm i pajtueshmërisë me Traktatin e TFK-së.

Mëtimet ruse se NATO ka shpërfillur shqetësimet e saj mbi mbrojtjen kundërraketë

NATO nuk i ka shpërfillur shqetësimet e Rusisë. Në të kundërtën, Aleanca ka kërkuar vijimisht bashkëpunim me Rusinë për mbrojtjen kundërraketë. Në Takimin e Lisbonës të vitit 2010, kërret e shteteve dhe të qeverive të NATO-s “vendosën të zhvillojnë një aftësi të mbrojtjes kundërraketë për të mbuluar të gjitha popullsitë evropiane të NATO-s, territorin e forcat, dhe ftuan Rusinë për të bashkëpunuar” (deklarata [këtu](#)).

Kjo u përsërit në Takimin e Çikagos në maj 2012 ([këtu](#)), ku udhëheqësit nënvizuan se NATO “mbetet e vendosur në bashkëpunimin për mbrojtjen kundërraketë në frymën e besimit dhe të përfitimit të ndërsjellë” dhe shpallën qartësisht se mbrojtja kundërraketë e NATO-s “nuk do të dëmtojë aftësitë e parandalimit strategjik të Rusisë”. NATO propozoi gjithashtu një regjim të transparencës, duke përfshirë krijimin e dy qendrave të përbashkëta NATO-Rusi të mbrojtjes kundërraketë. Rusia nuk i ka pranuar këto oferta.

Këto deklarata të Takimeve janë më shumë se premtime politike: ato karakterizojnë politikën e NATO-s. Në vend që të përfshihet në bashkëpunimin me NATO-n, Rusia është thelluar në argumente që nuk marrin parasysh rregullat bazë, si dhe politikën e shpalosura nga NATO. Ekspertë të pavarur ushtarakë rusë kanë bërë të qartë se programi i mbrojtjes kundërraketë të NATO-s nuk mund të paraqesë ndonjë kërcënim për Rusinë apo të zvogëlojë frytshmërinë e forcave të saj parandaluese strategjike. Qeveria ruse e ka përdorur mbrojtjen kundërraketë më shumë si një shfajësim për akuzat se sa një mundësi për partneritet.

Kritika ruse e legjitimitetit të veprimeve ushtarake të NATO-s – Libi

Në kërkim për të mbrojtur veprimet e saj të paligjshme në Krime, Rusia ka sulmuar legjitimitetin e disa prej operacioneve të NATO-s.

Kjo përfshin operacionin e drejtuar nga NATO të vitit 2011 për mbrojtjen e civilëve në Libi. Operacioni i drejtuar nga NATO u ndërmor nën autoritetin e dy rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (KSOKB), rezoluta [1970](#) dhe [1973](#) të KSOKB-së, të dyja në përmendje të Kapitullit VII të Kartës së OKB-së dhe asnjëra prej të cilave nuk ishte kundërshtuar nga Rusia. Presidenti Putin kohët e fundit akuzoi NATO-n për shkelje të rezolutave duke bombarduar Libinë. Kjo është krejtësisht e pasaktë.

Rezoluta 1973 e KSOKB-së autorizoi NATO-n “për të marrë të gjitha masat e nevojshme” për të “mbrojtur civilët dhe zonat e populluara civile nën kërcënimin e sulmit”, çka është ajo që bëri NATO, me mbështetjen politike dhe ushtarake të shteteve rajonale dhe të anëtarëve të Lidhjes Arabe.

Pas konfliktit, NATO bashkëpunoi me Komisionin Ndërkombëtar të OKB-së për Hetimet mbi Libinë, i cili nuk gjeti asnjë shkelje të Rezolutës 1973 të KSOKB-së apo të së drejtës ndërkombëtare, duke përfunduar në të kundërtën se “NATO drejtoi një fushatë tejet të përpiktë me një vendosmëri të dëshmuar për të shmangur viktimat civile”.



Kritika ruse e legjitimitetit të veprimeve ushtarake të NATO-s – Kosovë

Operacioni i NATO-s në lidhje me Kosovën u krye pas një periudhe mbi njëvjeçare përpjekjesh të pareshtura nga ana e OKB-së dhe e Grupit të Kontaktit, në të cilat Rusia ishte anëtare, për të sjellë një zgjidhje paqësore. Këshilli i Sigurimit i OKB-së, në disa raste, e dënoi spastrimin etnik në Kosovë dhe numrin në rritje të refugjatëve të dëbuar nga shtëpitë e tyre si një kërcënim ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Pavarësisht nga mungesa e autorizimit të Këshillit të Sigurimit, Operacioni i Forcave Aleate të NATO-s u ndërmor për të parandaluar shkeljen në shkallë të gjerë dhe të vijueshme të të drejtave të njeriut dhe vrasjen e civilëve.

Pas fushatës ajrore, operacioni i mëpasshëm i drejtuar nga NATO, KFOR, i cili fillimisht përfshinte Rusinë, ka qenë nën mandatin e OKB-së (Rezoluta [1244](#) e KSOKB-së), me synimin për të siguruar një mjedis të qetë dhe të parrezikuar për Kosovën. Kjo çoi në gati dhjetë vjet diplomaci, nën autoritetin e OKB-së, për gjetjen e një zgjidhjeje politike dhe për të vënë në vijë statusin përfundimtar të Kosovës, ashtu siç parashihet nga Rezoluta 1244 e KSOKB-së.

Operacioni i Kosovës u krye pas diskutimeve shteruese me përfshirjen e të gjithë bashkësisë ndërkombëtare për të zgjidhur një krizë tejet të kohëzgjatur. Në Krime, pa asnjë shenjë të ndonjë krize dhe pa asnjë përpjekje për të bashkëbiseduar ndonjë formë zgjidhjeje, Rusia anashkaloi të gjithë bashkësinë ndërkombëtare, përfshirë OKB-në dhe thjesht pushtoi një pjesë territori të një vendi tjetër.

Mëtimet ruse se autoritetet ukrainase janë të paligjshme

Presidenti dhe qeveria e tanishme e Ukrainës u miratuan nga një shumicë dërrmuese në parlamentin ukrainas (371 vota nga 417 të regjistruar) më 27 shkurt 2014, përfshirë anëtarë të Partisë së Rajoneve.

Ai parlament u zgjodh më 28 tetor 2012. Në atë kohë, Ministria e Jashtme e Rusisë deklaroi se zgjedhjet ishin mbajtur “në mënyrë paqësore, pa çrregullime dhe në përputhje me standardet e pranura përgjithësisht” dhe “pohoi vendosmërinë e Ukrainës ndaj demokracisë dhe rendit ligjor”. Deklarata mund të lexohet në rusisht [këtu](#).

Parlamenti të cilin Rusia e quajti të ligjshëm atëherë vështirë se mund të quhet i paligjshëm tani.

Mëtimet ruse se i ashtuquajtimi referendum në Krime ishte i ligjshëm

Zyrtarët rusë mëtojnë se i ashtuquajtimi referendum në Krime më 16 mars ishte i ligjshëm.

Referendumi ishte i paligjshëm sipas kushtetutës së Ukrainës (e pranishme në gjuhën ukrainase [këtu](#), në rusisht [këtu](#), në anglisht [këtu](#)), në të cilën theksohet se çështjet “e ndryshimit të territorit të Ukrainës zgjidhen vetëm nga një referendum gjithukrainas”. Krimea, si pjesë e Ukrainës, ka statusin e një republike autonome, por çdo çështje në lidhje me autoritetin e saj duhet të zgjidhet nga parlamenti ukrainas (neni 134) dhe kushtetuta e saj duhet të miratohet nga parlamenti ukrainas (neni 135).

Përveç kësaj, i ashtuquajtimi referendum u organizua brenda disa javëve nga një udhëheqje e vetëshpallur e Krimesë, që u vendos në pushtet nga trupa ushtarake të armatosura ruse pas pushtimit të ndërtesave qeveritare.

Mëtimet ruse se aneksimi i Krimesë ishte i përligjur sipas opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi pavarësinë e Kosovës

Udhëheqësit rusë mëtojnë se precedenti për të ashtuquajturën deklaratë të pavarësisë së Krimesë ishte opinionimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi pavarësinë e Kosovës (në internet [këtu](#)).

Megjithatë, gjykata deklaroi qartë se opinionimi i saj nuk ishte një precedent. Gjykata tha se çështjes rreth pavarësisë së Kosovës i ishte dhënë një hapësirë “e ngushtë dhe e veçantë”, e cila nuk do të përfshinte pasojat më të gjera ligjore të atij vendimi.

Gjykata theksoi rrethanat në të cilat mëtimet për pavarësi do të ishin të paligjshme. Kjo do të përfshinte nëse “ato ishin, ose do të kishin qenë, të lidhura me përdorimin e paligjshëm të forcës”. Një shembull i “një përdorimi të paligjshëm të forcës” do të ishte një pushtim dhe zaptim nga një vend fqinj – çka është pikërisht ajo që ka bërë Rusia.

Për më tepër, procesi që çoi në shpalljen e pavarësisë së Kosovës ishte shtrirë ndër vite dhe ka përfshirë një proces të gjerë të drejtuar nga Kombet e Bashkuara. Mëtimet ruse nuk i marrin parasysh të gjitha këto fakte.



Dega e Diplomacisë Publike (DDP) - Seksioni i Shtypit dhe i Medias

Tel.: +32(0)2 707 1010/1002

Email: moc@hq.nato.int

#NATO